

CV-JA E ORGANIZATËS PËRTEJ BARRIERAVE



ADRESSA: Rruga Don Bosko, Pallati Gener 2, Hyrja 1, Kati 6, Ap 51, Tirane - Kodi Postar 1026

KUTIA POSTARE: 87

DREJTORESHE EKZEKUTIVE: ANA MULLANJË

TELEFON: 00355 692091795

MAIL: office@beyondbarriers.org

WEBSITE: www.beyondbarriers.org

NIPT: K61702012D



MISIONI

Shoqata “Përtej Barrierave” është krijuar në Qershor të vitit 2004 me iniciativën e një grupi të rinjsh me aftësi të kufizuar dhe të rinj të tjerë. Përtej Barrierave është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, vullnetare që mbrohet të drejtat dhe interesat e të rinjve. **Misioni** i organizatës është të promovojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë dhe vecanërisht për të rinj me disavantazhe sociale duke u ofruar atyre mbështetje për tu fuqizuar dhe marrë pjesë aktive në jetën e komunitetit.

Organizata Përtej Barrierave punon në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe Europian. Të rinjtë e shoqatës angazhohen në projekte të ndryshme sidomos në fushat e përfshirjes sociale, edukimit të të rinjve për të drejtat e njeriut, vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen rinore, punësimin dhe sipërmarrjen, qytetarinë aktive dhe mësimin ndërkulturor.

OBJEKTIVAT

- Mbështetja e të rinjve me disavantazhe sociale për të zgjidhur në mënyrë të pavarur problemet që ata ndeshin në jetën e tyre të përditshme.
- Krijimin e mundësive për fuqizimin e individëve me më pak mundësi se të rinjtë e tjerë për të bërë zgjedhje të lira dhe për të arritur plotësimin profesional në jetë.
- Kryerja dhe nxitja e një sërë shërbimesh të adaptuar për nevojat e çdo të riu.
- Organizimi i të rinjve në grupe të ndryshme shoqërore duke ndihmuar për përmirësimin e zhvillimit të tyre në plan personal dhe social.
- Lëvizja drejt një modeli social në aftësinë e kufizuar.
- Ndërgjegjësimi i të rinjve me aftësi të kufizuar dhe shoqërisë për të drejtat e tyre etj.
- Eliminimi i diskriminimit kundër individëve me aftësi të kufizuar.



PROGRAMET STRATEGJIKE


Në planin e saj Strategjik 2021-2024, Përtej Barrierave ka 7 programe pune.

1. **Edukimi për të drejtat e njeriut**- Informimi, edukimi dhe ngritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut, përmes metodologjisë së edukimit jo formal.
2. **Përfshirja dhe Diversiteti** –Promovimi i përfshirjes dhe diversitetit për të përparuar dhe ofruar mundësi dhe shanse të barabarta për grupet me mundësi më të pakëta.
3. **Puna me të rinjtë**- Zhvillimi, promovimi dhe njohja e punës cilësore me të rinjtë në Shqipëri në nivel kombëtar, rajonal dhe Europian.
4. **Vullnetarizmi** - Promovimi i vullnetarizmit në nivel kombëtar, rajonal dhe Europian, si një mjet për rritjen e solidaritetit dhe kohezionit social të komunitetit, përmes mbështetjes së zhvillimit më të mirë të politikave dhe strukturave vullnetare.
5. **Punësimi dhe Sipërmarrja**- Rritja e kompetencave të të rinjve dhe punëtorëve të rinj në punësim dhe sipërmarrje përmes ndërtimit të kapaciteteve, hulumtimeve, advokimit dhe zhvillimit të politikave.
6. **Pjesëmarrja e të rinjve dhe Qytetaria Aktive**- Nxitja dhe fuqizimi i të rinjve për të marrë pjesë aktive në jetën e komunitetit përmes përmirësimit të aftësive dhe promovimit të katër dimensioneve të qytetarisë.
7. **Dixhitalizimi dhe Inovacioni** – Krijimi i një mjedisi mundësues për qasje të reja dixhitale dhe inovatore, për të nxitur mësimin dixhital dhe kreativitetin në edukim.

Aktivitetet që implementojmë janë fushata ndërgjegjësimi online dhe offline, debate, shkëmbime rinore, advokaci e lobim për çështje që i përkasin të rinjve, trajnime, seminare, kampe verë, flash mobs, forume, konferenca, Living library, kurse online, etj.



ORGANOGRAMA



PËRFAQËSIM

- PIKË KONTAKTI e programit Erasmus + Youth in Action dhe programin European Solidarity Corps

Nga Maji 2010 e në vazhdim, Përtej Barrierave është kontraktuar nga SALTO SEE si Pikë Kontakti për Shqipërinë për programin Erasmus+ Youth in Action 2014-2020 dhe ESC të Komisionit Evropian. Në kuadër të këtij përfaqësimi, Përtej Barrierave ofron mbështetje, trajnim dhe informim për të



gjitha organizatat dhe individët e interesuar për të njohur programet Erasmus+YiA dhe ESC në vendin tonë.

- Akreditim për EVS në programin Erasmus+Youth in Action

Përtej Barrierave është organizatë e akredituar me Etiketën e Cilësisë (Quality Label) për menaxhimin e programit European Solidarity Corps, në rolet si organizate dërguese, pritëse dhe koordinuese e vullnetarizmit. Në këtë rol Përtej Barrierave ka dërguar në shërbimin vullnetar evropian mbi 200 të rinj nga Shqipëria si dhe ka pritur në Shqipëri mbi 250 të rinj Evropian të cilët kanë kryer shërbimin vullnetar në Përtej Barrierave.



NJOHJE DHE TITUJ

Në vitin 2018, Përtej Barrierave është vlerësuar me titullin **“Organizata Rinore e Vitit 2018”**, i akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise dhe Shërbimi Kombëtar për Rininë.

Në vitin 2012, në eventin **Çmimi i vullnetarizmit 2012**, Përtej Barrierave mori titullin **“Organizata me standardet më të larta në punë dhe në vlerësimin e njohjen e vullnetarizmit”**. Ky titull u akordua Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, 5 Dhjetor, nga MTKRS, UN Volunteers dhe KRSH.

Në vitin 2011, cilësuar si **Përvjetori i 10-të i Vullnetarizmit**, Përtej Barrierave mori titullin **“Projekti më i suksesshëm për Vullnetarizmin 2011”**, me motivacionin **“Për kontributin e shquar në nxitjen dhe promovimin e vullnetarizmit”**. Ky titull u akordua në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, 5 Dhjetor, nga MTKRS, UN Volunteers dhe KRSH.

Projekti **“Kreativiteti dhe inovacioni për qytetatri aktive -Creativity and innovation for active Citizenship”** i zbatuar nga Përtej Barrierave në nivel evropian organizuar 11-19 Nëntor 2009 me 33 të rinj nga vende të Evropës **u përzgjedh nga Komisioni Evropian si një ndër projektet më të suksesshëm për vitin 2010.**

PARTNERITETE NDËRKOMBËTARE

- SOUTH EASTERN EUROPE YOUTH NETWORK (SEEYN)

Pertej Barrierave eshte anetare me te drejta te plota ne rrjetin e Ballkanit Perendimor SEEYN i cili ka 24 organizata partnere ne 12 shtete. Misioni i rrjetit eshte te kontribuojne ne zhvillimin e nje shoqerie me paqesore dhe te qendrueshme duke fuqizuar te rinjte permes aktivizmit, pjesemarrjes, punesimit, edukimit dhe bashkepunimit. Me shume informacion gjeni ne www.seeyn.org

- **UNITED for Intercultural Action**

UNITED eshte nje rrjet European kunder nacionalizmit, racizmit, fashizmit dhe qe mbeshtet migrantet,, refugjatet dhe minoritetet. Rrjeti ka mbi 560 organizata mbeshtetese ne te gjithë Europen dhe te koordinuara organizojne cdo vit fushata, konferenca, projekte dhe publikime te ndryshme qe synojne te advokojne dhe protestojne ndaj diskriminimit dhe te promovojne nje shoqeri diverse dhe gjithepershires. www.unitedagainstracism.org

- **TDM 2000 International**

Rrjet organizatash evropiane me baze ne Itali, te cilat punojne sebashku nen ombrellen e TDM2000Int, per te permiresuar cilesine e aktiviteteve rinore dhe per te promovuar bashkepunim dhe ndarje eksperiencash mes anetareve te rrjetit. www.tdm2000international.org

DONATORËT

Disa nga donatorët më të rëndësishëm gjatë viteve janë:

- Komisioni European (Programet Erasmus+YiA, Europe for Citizens, ESC, Fondet IPA)
- Këshilli i Europës,
- European Youth Foundation
- SALTO SEE,
- RYCO,
- Visegrad Funds,
- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- Ministria e Kulturës,
- Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë
- Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës
- Ambasada Amerikane në Shqipëri;
- Lëviz Albania;
- Fondacioni SOROS,
- AMSHC,
- Balkan Children and Youth Foundation,
- Share SEE,
- Handicap International,
- Kind Zijn Trust,
- UNICEF
- ETJ.

Na gjeni në:

www.beyondbarriers.org / [Beyond Barriers - Pertej Barrierave](#) | [Facebook](#) / [BBA-AL \(@beyondbarriersngo\)](#)
• [Instagram](#)